



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:180703  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05721375

**C.nr.106/16**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.B. nga fshati K./Malishevë, kundër të paditurit F. Z. B. nga fshati K./ Malishevë, me objekt kontesti: “Për vërtetimin e të drejtës së pronësisë”, vlera e kontestit 5,000.00 euro, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 22.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.106/16 të datës 22.06.2016, sipas padisë së paditësit (tani të ndjerit) B.B. nga fshati K./Malishevë, kundër të paditurit F. B. po ashtu nga fshati K./ Malishevë, për shkak të vdekjes së paditësit.
- II.** Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdohet kur trashëgimtari/trashëgimtarët e paditësit apo kujdestari i pasurisë trashëgimore ta marrin përsipër procedurën, apo kur t’i thërrasë gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi B. B. nga fshati K./Malishevë, pranë kësaj gjykate me datë 22.06.2016 ka parashtruar padi ndaj të paditurit F. B., me objekt kontesti “Vërtetim i të drejtës së pronësisë”, me vlerë të kontestit 5,000.00 €.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.106/16 të datës 23.02.2024, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit për përgjigje në padi, kurse me datë 22.05.2024 në ora 13:30, gjykata ka caktuar seancën përgatitore, ku për paditësin nuk ka prezantuar askush dhe sipas fletë kthesës së postës thuhej se “pala ka vdekur”, ndërsa për të paditurin ka prezantuar personalisht i padituri F. B. identiteti i të cilit është vërtetuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal .....

Në këtë seancë, i padituri e ka njoftuar gjykatën se paditësin B.B.e ka axhë (vëlla të babait) dhe se ai ka vdekur në vitin 2020 dhe si provë, gjykatës ia ka dorëzuar certifikatën e vdekjes me numër serik V ...të datës 22.05.2024.

Gjykata ka konstatuar se në bazë të certifikatës së vdekjes, me numër serik V ..., dhe me numër reference ... të datës 22.05.2024, vërtetohet se tani i ndjeri B. B. me numër personal ... i lindur me 03.02.1950 në K., ka vdekur me datë 29.03.2020 në K..

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika a) të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”*. Bazuar në faktin se Gjykata disponon me dëshmi shkresore në drejtim të argumentimit të faktit se i paditësi B.B. ka vdekur dhe një rrethanë e tillë paraqet pengesë për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore, andaj në kuptim të dispozitës së lartcekur nga neni 277 pika a) të LPK-së janë plotësuar prezumimet për ndërprerjen e procedurës.

Vendosjen si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 280 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhdimit eventual të procedurës.

Andaj, në një gjendje të këtillë dhe mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.106/16, datë 22.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.